



Datë: 12.06.2025

Numër Protokoll: 4190/2025

A.nr.775/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Arditë Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Hava Fekaj-procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.775/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja S.S, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, në pajtim në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.775/2025, e datës 30.04.2025, e parashtruar nga ankuesja S.S., ashtu që **shfuqizohet** Vendimi me numër 128/2025 i datës 17.05.2025 i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa lënda kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosije** tek organi i njëjtë.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, në mënyre që të rishqyrtoj rastin e ankueses.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile S.S, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 30.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2866/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.775/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.128/2025 të datës 17.04.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë

e Financave, Punës dhe Transfereve, mbi të cilin akt i është refuzuar kërkesa për pezullim vullnetar nga marrëdhënia e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 02.06.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2866/2025, të datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin Nr.128/2025 me numër protokolli 1150/2025 të datës 17.05.2025; Kërkesën me numër protokolli 1150 të datës 15.04.2025; E-mailin e datës 10 prill 2025-Njoftim për pushim pa pagesë; Vendimi për pensionin e personave me aftësi të kufizuar (emri i përfituesit i palexueshëm); Vendimi për njohjen e pensionit të personave me aftësi të kufizuar (jo krejt i lexueshëm); Kopja e Pasaportës të ankueses; E-maili i datës 30/04/2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 02.06.2025; Akt Emërimit me Nr.protokolli 1072 të datës 04.05.2024; Përshkrimin e detyrave të punës; E-maili i datës 28 maj 2025 lidhur me refuzimin e kërkesës për lejim in e pushimit pa pagesë e parashtruar nga Znj. S.S; E-maili i datës 14 prill 2025 lidhur me informata shtesë për pushim pa pagesë.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ***ri-shqyrtim*** dhe ***rivendosje të organi i njëjtë, sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokolli 1072/2024 të datës 04.05.2024, është e punësuar në pozitën e punës *Analiste e lartë i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Buxhetit*. Si rrjedhojë, e njëjta përmes shkresës me numër protokolli 1150/2025 të datës 15.04.2025, ka parashtruar kërkesë për pezullim vullnetar tek Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe atë për periudhën kohore prej 2 muajsh, për arsye të përkujdesjes së vjehërrit së saj i cili është person me aftësi të kufizuar dhe në gjendje tejet të rëndë shëndetësore, ankuesja ka bashkangjitur ; Vendimi për pensionin e personave me aftësi të kufizuar (emri i përfituesit i palexueshëm); Vendimi për njohjen e pensionit të personave me aftësi të kufizuar (jo krejt i lexueshëm);

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedhë se Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me Vendimin Nr.128/2025 të datës 17.05.2025, ka refuzuar kërkesën e lartë theksuar të ankueses, me arsyetimin se duke marrë parasysh mungesën e theksuar të stafit në MPFT dhe volumin e madh të kërkesave nga të gjitha organizatat buxhetore për Departamentin e Buxhetit, është refuzuar kërkesa për lejimin e pushimit pa pagesë e parashtruar nga Znj. S.S në pozitën Analiste e Lartë e

Buxhetit, Divizioni i Buxhetit Komunal, Departamenti i Buxhetit në kuadër të Ministrisë, Punës dhe Transfereve.

Kundër Vendimit Nr.128/2025 të datës 17.05.2025, ankuesja brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke theksuar se është e detyruar që të kërkoj pezullim vullnetar për arsye shëndetësore të vjehërrit të saj. Tutje ka shtuar se në vendimin e atakuar është cekuar se ka mungesa të theksuara të stafit të MFPT dhe volum të madh të kërkesave nga të gjitha organizata buxhetore të Departamentit të Buxhetit, andaj kjo gjë nuk është relevante për mua, sepse unë i kam arsyet e mia personale dhe familjare, andaj refuzimi me arsyetimin që Departamenti i Buxhetit ka mungesë stafi është inekzistent dhe jo real.

Ankuesja ka shtuar se pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 9 dhe 10 të Rregullores (QRK) Nr.28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, si për rrjedhojë i propozon Këshillit aprovimin e ankesës dhe anulimin e vendimit të kontestuar, ashtu që të njëjtës ti lejohet pushimi pa pagesë i marrëdhënies së punës nga dita e pranimit të vendimit.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses i'u referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 70 (Pezullimi vullnetar), i cili përcakton se: *1. Pezullimi vullnetar bëhet me kërkesë të nëpunëses/it civil në rastet si në vijim: 1.1. për kujdesin anëtares/it të ngushtë të familjes, të moshuar ose të sëmurë për një periudhë deri në një (1) vit; 1.2. për përgatitje profesionale për një periudhë deri në dy (2) vite. 2. Kërkesa për pezullim paraqitet me shkrim, së paku pesë (5) ditë para datës së kërkuar të pezullimit, sipas nën-paragrafit 1.1. dhe së paku tridhjetë (30) ditë sipas nën-paragrafit 1.2. të këtij neni në NjMBNj të institucionit. Kërkesa për pezullim miratohet nga udhëheqësj/i më i lartë administrativ i institucionit. 3. Në rast se nëpunësj/i civil që ka pezulluar marrëdhënien e punës sipas nën-paragrafit 1.2. të këtij neni, krijon marrëdhënien tjetër pune, kjo përbën shkak për lirim nga shërbimi civil. 4. Kategoria e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nuk kanë të drejtë në pezullimin vullnetar sipas nën-paragrafit 1.2. të këtij neni. 5. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike me akt nënligjor rregullon në mënyrë të hollësishme rregullat për zbatim të këtij neni.*; ndërlidhur me këtë e drejta e pezullimit të nëpunësve civil është e rregulluar edhe me Rregulloren Nr.28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, ku sipas nenit 9 (Pezullimi vullnetar) përcaktohet se: *1. Pezullimi vullnetar bëhet me kërkesë të nëpunësit civil në rastet si në vijim: 1.1. për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes, të moshuar ose të sëmurë për një periudhë deri në një (1) vit; 1.2. për përgatitje profesionale për një periudhë deri në dy (2) vite;*, si dhe nenit 10 (Procedura për pezullimin vullnetar), përcaktohet se: *1. Kërkesa për pezullim për kujdesin ndaj anëtarit të ngushtë të familjes që është i moshuar ose i sëmurë, duhet shoqërohet me rekomandimin nga mjeku se personi ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme për një periudhë të caktuar. 2. Kërkesa për pezullim për përgatitje profesionale, duhet të shoqërohet me dëshminë nga institucioni përkatës që ofron përgatitjen profesionale. 3. Kërkesa për pezullim në rastet sipas nënparagrafit 1.1 të paragrafit 1, të nenit 9 të kësaj Rregulloreje, paraqitet me shkrim së paku pesë (5) ditë para datës së synuar të pezullimit. 4. Kërkesa për pezullim në rastet sipas nënparagrafit 1.2, të paragrafit 1, të nenit 9 të kësaj Rregulloreje, paraqitet me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë para datës së synuar të pezullimit. 5. Kërkesa për*

pezullim i paraqitet NjMBNj-së së institucionit që pas shqyrtimit dërgohet tek zyrtari më i lartë administrativ i institucionit, i cili me vendim miraton apo refuzon kërkesën. 6. Kategoria e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, nuk kanë të drejtë në pezullimin vullnetar për përgatitje profesionale. 7. Në rast se nëpunësi civil që ka pezulluar marrëdhënien e punës për përgatitje profesionale krijon marrëdhënie tjetër pune, lirohet nga shërbimi civil.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura si më lartë, konstaton se nëpunësit civil kanë të drejtë që të kërkojnë pezullim vullnetar për përkujdesjen e anëtarit të ngushtë të familjes për një periudhë deri në një (1) vit, duke i bashkangjitur rekomandimin nga mjeku se personi ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme për një periudhë të caktuar, ndërsa është në diskrecion të Zyrtarit më të lartë administrativ të institucionit që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me kërkesën gjithnjë duke u bazuar në dokumentet apo raporte mjekësore të specialisteve të fushës përkatëse respektivisht dokumente bindëse përmes të cilave do të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e familjarit të ankuesit.

Kolegji i Këshillit në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore ka analizuar Vendimin Nr.128/2025 të datës 17.05.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së i njëjti bazohet në vërtetim jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatim jo të drejtë të dispozitave materiale, pasi që sipas vlerësimit të Kolegjit, i njëjti fare nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses lidhur me kërkesën e saj për pezullim vullnetar nga marrëdhënia e punës dhe se e njëjta marrjen e vendimit ka arsyetuar se duke marrë parasysh mungesën e theksuar në MPFT dhe volumin e madh të kërkesave nga të gjitha organizatat buxhetore për Departamentin e Buxhetit, duke mos i shqyrtuar fare provat e lëndës respektivisht vendimet dhe raportet mjekësore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ti kërkojë ankueses dhe shqyrtojë provat e relevante për pushim pa pagesë siç janë raportet mjekësore të vjehrrit të ankueses dhe Certifikatat e bashkësisë familjare dhe provat tjera relevante të cilat janë të nevojshme për marrjen e pushimit pa pagesë nga ankuesja në mënyrë që të rishqyrtoj rastin e ankueses.

Andaj, duke qenë së vendimi i atakuar përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, të Republikës së Kosovës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj kërkesën e ankueses, nëse është e nevojshme të kërkoj dokumente, përkatësisht vendime, Certifikaten e bashkësisë familjare apo raporte mjekësore tjera shtesë nga Institucionet Publike Shëndetësore të Republikës së Kosovës në mënyrë që të vërtetohet saktë dhe drejtë gjendja shëndetësore e anëtarit të ngushtë të familjes së ankueses dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.775/2025

Hava Fekaj

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses S.S;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve) si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.